



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 92-Shkurt 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga përrurimi i ujësjellësit në Turjakë



Përmbajtja:

Kryetari Kilaj priti në takim njohës komandantin e kontingjentit gjerman të KFOR-it	2
FSK filloi fushatën e rekrutimit të pjesëtarëve të rinj	4
Komuna do të mbështet FSSHK-në	5
Raport nga takimi i KKS-së	6
Është mirëpritur zbatimi i ligjit për duhanin	7
U formua komiteti për Arsim dhe Kulturë	9
Nga mbledhja e këshillit të drejtorëve	10
Seancë solemne me rastin e trevjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së shtetit të Kosovës	11
Të pastrohet dhe mirëmbahet ambienti dhe rrugët	14
KPF jep dy rekomandime për Kuvend	14
Mbahet takimi informues në lidhje me përgatitjet e Planit Zhvillimor Komunal	15
U përrua ujësjellësi në Turjakë	16
Nënshkruhet edhe një marrëveshje për ndërtim ujësjellësi	18
Kryetari i komunës priti qytetarët	19
Tetë nxënës nga komuna e Malishevës do të marrin pjesë në garat e Olimpiadës në Matematikë në nivel qendror	20
Formohet Komisioni për organizimin e zgjedhjeve nëpër fshatra	21

Kryetari Kilaj priti në takim njohës komandantin e kontingjentit gjerman të KFOR-it

Malishevë, 7 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur në një takim njohës, komandantin e ri të kontingjentit gjerman të KFOR-it, kolonelin Wolfgang Pirner, me të cilin biseduan për çështjet e përgjithshme të sigurisë dhe të gjendjes ekonomiko-sociale në territorin e komunës së Malishevës.

Kryetari Kilaj, fillimisht e uroi kolonelin Pirner, për detyrën e re, ndërkohë theksoj se gëzon respekt të veçantë në mesin e popullit të Malishevës dhe të Kosovës në përgjithësi. “Ne këtu, me KFOR-in gjerman kemi pasur relacione shumë të mira”, tha kryetari Kilaj, i cili më pas e njoftoi komandantin e kontingjentit gjerman, me gjendjen e përgjithshme në Malishevë, në aspektin e sigurisë dhe për zhvillimet tjera në komunë.

Njëkohësisht e njoftoj për disa shqetësime me të cilat përballen komuna, ndër të cilat radhiten papunësia dhe menaxhimi i mbeturinave, duke e pas parasysh (për këtë të fundit) që nuk bëhet riciklimi i mbeturinave dhe rrjedhimisht e vështirëson menaxhimin e tyre.

Në anën tjetër koloneli Pirner, shprehu interesimin për të hyrat vetjake të komunës, thithjen e fondeve për investime kapitale, investimet e huaja, mënyrën jetesës, etj. “Ju e keni përparësinë e fuqisë punëtore, pasi keni një moshë mesatare të re, ndërsa dy janë çështjet themelore me të cilat duhet të merreni, arsimimi profesional dhe hapja e vendeve të reja të punës, edhe pse kjo e fundit nuk varet shumë nga komuna”, tha koloneli Pirner, i cili mori shembullin e Gjermanisë, në të kaluarën, kur e kishte të njëjtin problem të papunësisë.

Koloneli Pirner, e njoftoi kryetarin Kilaj edhe për strukturimin e ri të KFOR-it, ku kontingjenti gjerman, do të mbetet me qendër në Prizren, ndërsa do të vazhdoj të jetë kontingjenti më i fuqishëm i KFOR-it, me numrin më të madh të ushtarëve, ndërsa “përgjegjësia do të jetë koncentruar në tërë KFOR-in”.

FSK filloi fushatën e rekrutimit të pjesëtarëve të rinj

Malishevë, 8 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur një delegacion nga komanda e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), me rastin e fillimit të fushatës për rekrutimin e pjesëtarëve të rinj në FSK. Me këtë rast delegacionit në fjalë iu është dhënë përkrahje e plotë në mbështetje të kësaj fushate.



Kryetari Kilaj, ka falënderuar FSK-në, për këtë fushatë edhe në Malishevë, duke ofruar të gjitha kapacitetet e komunës, në mënyrë që të bëhet informimi sa më i madh i të rinjve, për të aplikuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me shpresën që do të pranohen edhe të rinj të tjerë nga Malisheva, për tu bërë pjesëtar të FSK-së.

Regjistrimi për tu bërë pjesëtar i FSK-së, fillon nga data 14 shkurt dhe vazhdon deri më 21 mars, të këtij viti, ndërsa në Malishevë, ekipi mobil i rekrutimit do të qëndroj çdo të mërkure, duke filluar me 16 shkurt, pastaj 23 shkurt, 2, 9 e 16 mars, dhe do të vendosen në hyrje të Sheshit të Dëshmorëve, në qendër të qytetit, ku të interesuarit, do të mund të marrin aplikacionet dhe të marrin informacione më të hollësishme.

Sipas FSK-së, ky do të jetë rekrutimi i fundit, me çka parashihet edhe plotësimi i numrit të pjesëtarëve aktiv të FSK-së.

Të drejt aplikimi kanë të gjithë të interesuarit nga mosha 18-25 vjeçare, duhet të kenë së paku përgatitjen e mesme shkollore dhe të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.

Në këtë fushatë, po ashtu shpërndahen edhe broshura, përmes së cilave të interesuarit mund të njoftohen me mënyrën e aplikimit, kushtet, përfitimet, detyrat, trajnimet dhe gjithçka tjetër që ndërlidhet me këtë rekrutim të rinjve në FSK, si dhe informacionet e nevojshme, mund ti gjejnë edhe në ueb faqen e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, www.mksf-ks.org.

Komuna do të mbështet FSSHK-në

Malishevë, 10 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, i ka dhënë mbështetje Federatës së Sportit Shkollor të Kosovës (FSSHK), duke i premtuar kësaj të fundit, futjen në politikat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, por edhe në organizimin e garave sportive shkollore. Kjo mbështetje është dhënë sot, gjatë një takimi që ka pasur kryetari i komunës me Enver Haradinajn-kryetar i FSSHK-së dhe zyrtarin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Xhafer Murtezajn dhe zyrtarin e departamentit të sportit në këtë ministri, z. Fitim Arifin.



“Unë e përgëzoj formimin e kësaj federate dhe ju siguroj që komuna, do të mbështes shtrirjen e saj edhe në shkollat e komunës së Malishevës, si dhe futjen e garave sportive shkollore në agjendën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport”, ju tha kryetari Kilaj, zyrtarëve të FSSHK-së dhe të MKRS-së. Po ashtu z. Kilaj, i njoftoi të pranishmit edhe me investimet komunale në



infrastrukturën sportive në shkolla, si dhe për angazhimin e tij, si pjesë e programit qeverisës, për krijimin e terreneve sportive në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës.

Zyrtarët e FSSHK-së dhe të MKRS-së, e njoftuan kryetarin Kilaj, me organizimin e kësaj federate të sportit shkollor, si dhe për rëndësinë e këtyre aktiviteteve sportive në shkolla, ndërsa sipas tyre, do të krijohet edhe një sistem databazë, për regjistrimin e ekipeve sportive, në të gjitha fushat e sportit, për të gjitha shkollat, ku parashihet që çdo shkollë të ketë ekipet e veta në sportet e caktuara.

Sipas Enver Haradinajt, këtë vit, kjo federatë do të merr pjesë në garat ndërkombëtare të notit, që do të mbahen në Maltë, e ku do të merr pjesë edhe një garues shkollor, nga komuna e Malishevës, e po ashtu, shkollarët kosovar, do të marrin pjesë edhe në një garë ndërkombëtare në sportin e tenisit.

Ndërsa Xhafer Murtezaj nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, premtoi dhe u shpreh shumë optimist, se brenda këtij viti, do të përurohet edhe Palestra Sportive në Malishevë. “Këtë vit, duhet të përurohet Palestra Sportive në Malishevë”, tha Murtezaj.

Ndërsa Fitim Arifi, tha se “synim i tyre është masivizimi i garave sportive dhe pjesëmarrja në të gjitha sportet dhe garat ndërkombëtare”.

Raport nga takimi i KKS-së

Malishevë, 10 shkurt

Muaji janar i këtij viti, është cilësuar si muaj, i cili ka prishur imazhin e mirë të Malishevës, në aspektin e sigurisë së përgjithshme, pasi është karakterizuar me rritje të rasteve të veprave penale dhe aksidente të shumta në trafik, kanë vlerësuar anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).



“Siguria e përgjithshme në komunën e Malishevës gjatë vitit 2010, bazuar në raportet e të gjitha organeve të sigurisë, ka qenë e qetë dhe stabile, por fillimi i vitit 2011, ka qenë tronditës me një ngjarje tragjike në fshatin Banjë”, ka thënë drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Zogaj.

Po ashtu edhe sipas Policisë së Kosovës, stacioni në Malishevë, viti 2010, ka qenë i qetë, por muaji janar i këtij viti, është karakterizuar me rritje të rasteve të kryerjes së veprave penale, ku janë shumë arrestime, si dhe ka janë regjistruar 29 aksidente trafiku, por për fat të mirë, pa raste me fatalitet.

Kurse, nënkoloneli Shemsi Sylja, nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), i cili ishte i pranishëm në takimin e sotëm, ka njoftuar se kjo forcë, është në fazën e përmbushjeve të kapaciteteve të plota, sipas standardeve, si dhe ka njoftuar për rekrutimin e pjesëtarëve të rinj, me të cilët plotësohet numri i pjesëtarëve aktiv të FSK-së.

Është mirëpritur zbatimi i ligjit për duhanin

Malishevë, 10 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj dhe drejtoresha e Inspektoratit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës (IAUV), Iliriana Zymberi, kanë vlerësuar se zbatimi i ligjit mbi duhanin, është mirëpritur mjaft mirë nga ana e subjekteve afariste, por edhe nga qytetarët dhe zbatimi i ligjit po ecën shumë mirë.

“Jam ithtar i zbatimit të ligjeve, e në rastin konkret, edhe të ligjit mbi duhanin. Inspektorët komunal, i kanë njoftuar të gjitha subjektet afariste dhe kjo po ecën mjaftë mirë në Malishevë”, tha kryetari Kilaj, gjatë takimit me përgjegjësit e Inspektoratit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës.

“Zbatimi i ligjit të duhanit është mirëpritur dhe aksioni i zbatimit të ligjit po shkon shumë mirë”, tha drejtoresha e IAUV-së, znj. Iliriana Zymberi. Ajo po ashtu tha se përkundër mungesës së inspektorëve në nivel qendror, kanë përkrahjen e drejtorive komunale në tërë vendin.

Të dy palët, më pas kanë biseduar edhe nevojën e kontrollit më të madh të ushqimit që konsumohet, me theks të veçantë, për thertoret dhe shërbimin e mishit, pasi ka dyshime nga ana e qytetarëve për cilësinë e mishit dhe prejardhjes së tij, përderisa thertoret duhet të kenë licencë për kryerjen e therjes së kafshëve, si dhe u diskutua nevoja e domosdoshme, që Malisheva të ketë një inspektor të veterinarisë, në mënyrë që të kontrollohet therja e kafshëve dhe shërbimi i mishit për konsumatorët.

U formua komiteti për Arsim dhe Kulturë

Malishevë, 11 shkurt

Në një takim të mbajtur sot, në mes të përfaqësuesve të subjekteve politike, pjesëmarrës me shumicë në kuvendin e komunës, është formuar Komiteti për Arsim dhe Kulturë. Ky Komitet do të veproj si organ i Kuvendit të Komunës, ndërsa përbëhet prej pesë anëtarëve, dy nga subjekti i Partisë Demokratike- PDK, dy nga Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK, dhe një nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK.



Me shumicë të votave kryesuese e këtij komiteti u zgjodh u zgjodh Raimonda Krasniqi, këshilltare komunale nga radhët e PDK-së, ndërsa anëtar tjerë të këtij komiteti janë edhe Naim Morina (PDK), Diturie Morina (AAK), Sadri Robaj dhe Qerim Kastrati (LDK).

Sipas rregullores për formimin e komiteteve, shumica e anëtarëve, duhet të jenë anëtar të Asamblesë Komunale.

Mbledhjen e parë inauguruese e udhëhoqi kryesuesi i Asamblesë Komunale, Ragip Begaj, ndërsa duke folur për rëndësinë e formimit të këtij komiteti, ai tha se “arsimi dhe kultura janë çështje



shumë me rëndësi, prandaj edhe ka qenë i nevojshëm formimi i këtij komiteti”, ndërkohë premtoj bashkëpunim mes tij si kryesues i kuvendit dhe komitetit të sapo formuar.

Nga mbledhja e këshillit të drejtorëve

Malishevë, 14 shkurt

Në mbledhjen e sotme të radhës të Këshillit të Drejtorëve, e udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, janë diskutuar disa çështje, në mesin e të cilave edhe mbajtja e mbledhjes solemne me rastin e tre vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Kryetari Kilaj, tha se “të mërkurën, pas mbajtjes së mbledhjes solemne me rastin e tre vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, do të vendosen kurora dhe do të bëhen nderime në varrezat e dëshmorëve në komunën tonë”.

Në këtë mbledhje, drejtori për buxhet dhe financa, kërkoi që të formohet një komision për verifikimin e bizneseve jo aktive, të cilat ligjërisht kanë obligime ndaj komunës, ndërsa në anën tjetër nuk ushtrojnë veprimtari.

Po ashtu u njoftua se gjatë fundjavës, janë bërë disa intervenime me zhavorr, në rrugët që nuk janë të asfaltuara.

Seancë solemne me rastin e trevjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së shtetit të Kosovës

Malishevë, 16 shkurt



Kuvendi i Komunës së Malishevës, më një mbledhje solemne ka është shënuar tre vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Fjalë rasti kanë mbajtur, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, udhëheqësit e grupeve përfaqësuese në Kuvend, ndërsa pas mbledhjes, janë vendosur lule pranë shtatores së Komandantit Legjendar, Adem Jashari në Sheshin e Dëshmorëve në Malishevë, si dhe janë bërë homazhe para pllakës me emrat e 70 dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Përveç këshilltarëve komunal, në seancën e sotme kanë marrë pjesë edhe deputetja e Parlamentit të Kosovës, zonja Hasime Mazreku-Krasniqi, e dalë nga zgjedhjet e fundit në vend, përfaqësues dhe familjarë të dëshmorëve të kombit, veteran dhe invalid të luftës së UÇK-së, drejtues të institucioneve në Komunën e Malishevës, ish kryetarët e Komunës së Malishevës dhe të tjerë.

Në emër të grupit të Këshilltarëve të Partisë Demokratike të Kosovës, ka folur këshilltari Enver Hoti, në emër të grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, këshilltari Januz Kastrati, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Diturie Morina, në emër të Aleancës Kosova e Re, Hafir Rexha dhe në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, Milazim Rudi, pastaj përfaqësuesi i shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, Halil Berisha dhe ish kryetari i Malishevës, z.Daut Krasniqi.

Në vazhdim, fjalimi i Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, i mbajtur me rastin e shënimit të trevjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.



Të nderuar anëtarë të kuvendit, të nderuar mysafir, të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje solemne,

Jemi mbledhur sot që së bashku të kremtojmë tre vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, duke mos harruar me këtë rast përpjekjet dhe sakrificat e pa shembulltë të brezave të tërë të cilët sollën datën e madhe historike të 17 shkurtit 2008.

Në Tri vite të shtet ndërtimit, Kosova ka ndërtuar institucionet e saja demokratike, ka shënuar suksese të shumta në ndërtimin e jetës së qytetarëve të saj si dhe është bërë faktor i paqes në rajonin dikur të trazuar të Ballkanit.

Tri vite të ndërtimit të shtetit nuk janë shumë por sukseset e kësaj periudhe vërtet janë të shumta pasi tashmë ajo njihet nga 75 shtetet më të fuqishme të botës kurse këto njohje pritet të rriten shpejt pas mbrojtjes së shkëlqyeshme të Pavarësisë së saj në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Veç kësaj, Kosova tashmë është anëtare e Bankës Botërore, e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e organizatave tjera të shumta kurse është në rrugë të mirë që së shpejti të jetë edhe anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Të nderuar pjesëmarrës, zonja dhe zotrinjë,

Bashkë me shtetin e Kosovës, në këto tri vite ka ecur edhe komuna e Malishevës e cila pikërisht gjatë kësaj periudhe ka shënuar zenitin e zhvillimit dhe të përparimit të saj pasi për përmirësimin e jetës së qytetarit të kësaj komune krahas infrastrukturës rrugore e cila tashmë është rumbullakësuar, ka shënuar suksese të mëdha edhe në fushat tjera. Pikërisht gjatë këtyre tri viteve janë ngritur shkolla të reja në shumë vendbanime në mesin e të cilave edhe Qendra e Kompetencës e cila ka vlerën e një universiteti rajonal.

Është ky projekti më i shtrenjtë që është ngritur ndonjëherë në Malishevë pasi vlera e tij kalon 5 milion euro kurse krahas tij dhe shkollave tjera, në përdorim janë lëshuar edhe ujësjellës, kanalizime si dhe projekte tjera të cilat do të ndikojnë në jetën më të mirë të qytetarit.



Ne po vazhdojmë edhe me ngritjen e projekteve tjera shumë të rëndësishme si janë Shtëpia e Kulturës, Pallati i Sporteve, ngritja e shkollave të tjera si dhe projekte të tjera të nevojshme.

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Për ngritjen e një jete më të mirë për qytetarët e komunës së Malishevës, ju ftoj që të vazhdojmë me punën tonë të përbashkët pasi të gjithë ne kemi një obligim sepse na obligojnë sakrificat e mëdha të këtij populli, gjaku i derdhur i brezave, lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me në krye komandantin legjendar Adem Jashari.

Në këtë ecje dhe në këta përvjetor, Malisheva ka të drejtë të mburret për kontributin e saj në lirinë e Kosovës pasi vetëm gjatë luftës së fundit të UÇK-së i dha Kosovës 70 dëshmor, rreth 400 martir, pothuaj tërë pasurinë e krijuar për decenie e cila u shkatërrua në flakët e luftës kurse edhe tash 40 qytetarë të kësaj komune konsiderohen të zhdukur pasi gjatë luftës janë rrëmbyer nga formacionet serbe.

Konsiderojmë se vlera e Pavarësisë së Kosovës matet në radhë të parë me përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe në këtë drejtim ne do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim dhe pa u ndalur për ngritjen e projekteve tjera të cilat do të lehtësojnë jetën e qytetarit të Malishevës pasi ata e meritojnë një gjë të tillë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Urime Tre vjetori i Pavarësisë,

Rroftë Republika e Kosovës

Nga takimi i rregullt i Këshillit të Drejtorëve



Të pastrohet dhe mirëmbahet ambienti dhe rrugët

Malishevë, 21 shkurt

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, e kryesuar nga kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, është kërkuar që ambienti të mirëmbahet dhe rrugët gjithashtu të jenë të pastruara çdo ditë dhe të mos ketë mbeturina.

“Kompania që menaxhon me mbeturinat, duhet të mirëmbajë dhe të pastroj në mënyrë të rregulltë, me qëllim që rrugët të jenë çdo herë të pastra”, kështu ka kërkuar kryetari Kilaj, nga Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe ka kërkuar nga drejtori, që liqeni “Mirusha”, të pastrohet nga mbeturinat e sjella nga uji i lumit dhe ato që janë mbetur përreth liqenit.

Në këtë takim, është njoftuar, se është kryer edhe një shpim i thellë, për ujë, në afërsi të fshatit Qupevë, ndërsa tani duhet të bëhen analizat e ujit dhe testet e nevojshme, në mënyrë që të vazhdohet me projekte të ujësjellësit në drejtim të Bubavecit, si dhe u njoftua për përrurimin e ujësjellësit në fshatin Turjakë, i cili do të bëhet të mërkurën me 23 shkurt.

Pjesë e diskutimit, ishte edhe ecuria e procesit të regjistrimit të popullatës, ekonomive familjare dh banesave, në komunën e Malishevës, që pritet të filloj së shpejti në mbarë Republikën e Kosovës.

KPF jep dy rekomandime për Kuvend

Malishevë, 21 shkurt



Komiteti për Politikë dhe Financa, organ i Kuvendi të Komunës së Malishevës, në mbledhjen e saj të radhës, ka shqyrtuar dhe ka miratuar dy rekomandime për seancën e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Njëra nga rekomandimet, e cila është votuar nga të gjithë anëtarët e KPF-së, është Rregullorja për Tarifat mbi Ngarkesat dhe Gjobat në territorin e komunës së Malishevës.

Po ashtu me vota unanime, është rekomanduar për Kuvend të Komunës edhe kërkesa e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, për fillimin e procedurave për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive të vendbanimeve dhe fshatrave të Komunës së Malishevës.

Ndërmjet përfaqësuesve të komunës së Malishevës dhe të UN-HABITAT

Mbahet takimi informues në lidhje me përgatitjet e Planit Zhvillimor Komunal

Malishevë, 22 shkurt

Ndërmjet përfaqësuesve të komunës së Malishevës, konkretisht kryetarit Isni Kilaj, drejtorit të Urbanizmit Esat Paçarizi dhe përfaqësuesve të UN-HABITAT-it, Arijeta Himaduna e Gloriosa Hisari, është zhvilluar një takim informues në lidhje me përgatitjet e Planit Zhvillimor Komunal.

Sipas znj. Himaduna “UN-HABITAT-i, përmes Programit për Mbështetje Komunave në Planifikim, ka për qëllim përmirësimin e efikasitetit të përpjekjeve të planifikimit hapësinor në Kosovë, forcimin e dialogut në mes të qeverisë qendrore dhe lokale në çështjet e planifikimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të stafit profesional lokal dhe shoqërisë civile, për një pjesëmarrje aktive në procesin e planifikimit në nivelin lokal dhe mbështetjen e planit lokal të veprimit”.

Kryetari Kilaj, ka falënderuar përfaqësueset nga UN-HABITAT, për këtë mbështetje, dhe njëkohësisht ka shprehur gatishmërinë e ofrimit të stafit, që së bashku të hartojnë kornizat e Planit Zhvillimor Komunal, që paraqet një rëndësi shumë të madhe për komunën që ai drejton.

Nga ky takim informues do të pasojnë edhe takime të tjera deri te finalizimi i Planit Zhvillimor Komunal, për të vazhduar me pastaj me procedurat tenderuese.

U përrua ujësjellësi në Turjakë

Malishevë, 23 shkurt

Sot në fshatin Turjakë të komunës së Malishevës, është bërë përrimi i sistemit të ujësjellësit, me ç'rast ndërsa përrimin e tij e bënë Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe drejtoresha e Zyrës për Zhvillim Ekonomik të USAID-it, zonja Mary Hobbs.



Ndërtimi i ujësjellësit për fshatin Turjakë është mundësuar, falë bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit të Komunës së Malishevës dhe USAID-it, me nga 160 mijë euro, si dhe donacionit të Hidroregjionit, me ujëmatës, në vlerë prej 11 mijë e 500 euro, kurse përfitues janë 2400 konsumator të fshatit Turjakë.

Fillimisht, për projektin, ka folur Azem Kastrati, drejtor i Programit për Infasrukturë të Vogël të Ujit dhe Sanitacionit në Kosovë, SËIS, program që zbatohet nga OJQ-ja amerikane, International



Relief and Development (IRD), i cili tregoi se ky program është duke u zbatuar në katër komuna të Kosovës, në mesin e tyre edhe në Malishevë. Sipas tij, janë shtrirë 12 mijë metra rrejt shpërndarë për fshatin Turjakë, me kapacitet katër litra për sekond, sistem i cili është i dizajnuar për furnizimin e banorëve, për 25 vitet e ardhshme

Në ceremoninë e përvitshme, kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka falënderuar në mënyrë të veçantë, USAID-in për ndihmën e dhënë në realizimin e këtyre projekteve. “Tashmë kemi ndërtuar marrëdhënie shumë të mira me USAID-in, pasi ky është fshati i katërt që po e mbulojmë me rrjet të ujësjellësit, prandaj faleminderit shumë”, tha kryetari Kilaj, i cili, po ashtu ka falënderuar edhe kompaninë për menaxhimin e ujërave, “Hidroregjioni”.

“Uroj banorët e Turjakës pasi po realizohet ëndrra e tyre, por edhe e imja, për ujë të pijes dhe bashkë me juve pjesë e gëzimit jam edhe unë. Jam krenar dhe shumë i gëzuar që sot po e përurojmë këtë projekt, për furnizim me elementin jetik, ujin për pije. Po ashtu ndihem mirë, pasi po e realizoj edhe premtimin tim për sigurimin e ujit për pije, për fshatin Turjakë”, tha në fund kryetari Kilaj, duke i uruar banorët e Turjakës.

Drejtoresha e Zyrës për Zhvillimin Ekonomik të USAID-it, zonja Mary Hobbs, duke marrë fjalën, tha se “është kënaqësi kur merr pjesë në finalizimin e projekteve, si ky sot”. “Uji është jetë, dhe është kënaqësi që e kemi sjellë ujin në këto fshatra. Uji është çelës i jetës, por ai duhet të menaxhohet dhe të mbrohet, për t’ju shërbyer të gjithë qytetarëve. Decentralizimi i sektorit të shpërndarjes së ujit, do të përmirësojë jetën tuaj, ndërsa kjo më parë nuk ka qenë e mundur, pasi ky sektor, ka qenë i centralizuar. USAID, është duke përkrahur ndërmarrjet rajonale, për përmirësimin e sistemeve të ujit, në shpërndarje dhe në menaxhim”, tha zonja Hobbs.

Në emër të “Hidroregjinit Jugor”, ka përshëndetur dhe uruar, z. Zenel Zeneli, i cili u shpreh i kënaqur me punën e bërë, ndërsa ujësjellësin, e quajti, jetë për të ardhmen e banorëve të Turjakës.

Ndërsa, kryetari i fshatit Turjakë, z. Hashim Kastrati, falënderoj të gjithë për ndërtimin për e ujësjellësit. “Në emër të 2100 banorëve, ju falënderoj të gjithëve, që na keni mundësuar, që ne sot të kemi ujë të pastër”, tha Kastrati.

Në fund u shfaq edhe një program i shkurtër artistik, nga nxënësit e Shkollës fillore “Fehmi Agani” të këtij fshati.

Në mes të Komunës së Malishevës, USAID-it dhe HIDROREGJIONIT

Nënshkruhet edhe një marrëveshje për ndërtim ujësjellësi

Malishevë, 23 shkurt



Përdërisa sot, është përfunduar një ujësjellës për fshatin Turjakë, është nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi në këtë kontekst, në mes të Komunës së Malishevës, International Relief and Development (IRD), dhe HIDROREGJIONIT, të cilat gjithashtu kanë qenë ndërtues të ujësjellësit të lartëpërmendur.

IRD –Kosovë, kanë identifikuar dhe përzgjedhur si të realizueshëm zhvillimin e projektit për furnizim me ujë të pijshëm për fshatrat e Komunës së Malishevës. Projekti është brenda Biznes Planit të aprovuar të KRU”, kështu thuhet në mes tjerash në Marrëveshjen e Projektit, e nënshkruar sot, për ndërtimin e ujësjellësit të radhës. Vlen të theksohet se USAID-i është



financues (në mesin e të tre bashkëfinancuesve), ndërsa IRD në kuadër të saj, është implementuese e projektit.

Planifikohet që ky projekt, të realizohet për fshatrat Bubavec e Kijevë, varësisht nga sigurimi i burimit të ujit. Ndërsa projekti në total parashihet të kap shumën e afër 500 mijë euro. Pritet që punimet për fillimin e ndërtimit të fillojnë nga 15 prilli i këtij viti, ndërsa të gjitha procedurat e prokurimit do të udhëhiqen dhe ndërmerren nga IRD.

Kryetari i komunës priti qytetarët

Malishevë, 24 shkurt

Si çdo të enjte, edhe sot, kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur qytetarët, të cilët zakonisht vijnë për ndonjë konsultim, por edhe për të shprehur hallet dhe problemet e tyre, në kërkim të zgjidhjeve të mundshme.

Ndër problemet e qytetareve janë ato të natyrës socio-ekonomike, problemet me banim, etj.

Kryetari Kilaj, edhe sot, sikur edhe herëve të tjera, ka ofruar mbështetjen e komunës, varësisht nga rastet, por edhe ndihmën e tij, brenda mundësive dhe kompetencave si kryetar komune dhe si institucion i komunës.

Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve



Tetë nxënës nga komuna e Malishevës do të marrin pjesë në garat e Olimpiadës në Matematikë në nivel qendror

Malishevë, 28 shkurt

Në mbledhjen e sotme të Bordit të Drejtorëve, e kryesuar nga kryetari i komunës, z. Isni Kilaj, janë trajtuar disa çështje, kryesisht në lidhje me shënimin e ngjarjeve të marsit, por edhe për ngjarje dhe aktivitete të tjera.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, z. Isuf Morina, ka njoftuar për përfundimin e mbajtjes së garave në nivel lokal, në lëmin e matematikës, përfshirë këtu nxënësit e klasave të 9-ta, 10-ta, 11-ta dhe 12-ta. Nga kjo garë rezulton përfaqësimi në garat e Olimpiadës së Matematikës në nivel qendror, ku secila gjeneratë e lartpërmendur do të ketë nga 2 përfaqësues të përzgjedhur më të mirët.

“Nxënësit e përzgjedhur nga kjo fushë janë Esart Hoxha, SHFMU “Ismail Qemali”-Bellanicë, Nart Paçarizi, SHFMU “Emin Duraku”- Dragobil, Sejfi Hoxha e Alban Kryeziu, Gjumnazi “Abdyl Frashëri”-Malishevë (kl. 10), Arben Krasniqi e Ardit Paçarizi Gjumnazi Abdyl Frashëri”- Malishevë (kl. 11), Islam Foniqi e Bledian Paçarizi, Gjumnazi “Abdyl Frashëri”- Malisheve (kl. 12)”, kështu ka bërë të ditur drejtori DA-së na Malishevës, z.Morina.

Kryetari Kilaj, ka kërkuar nga drejtorët kompetent që të ndërmarrin masat përgatitore në lidhje me shënimin e Epopesë së UCK-së, por edhe shënimin e Ditës së Mësuesit dhe Ditës së Gruas.

Edhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, z. Esat Paçarizi, ka njoftuar për dorëzimin e 6 projekteve për renovim të shkollave, në Ministrinë e Pushtetit Lokal.

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Malishevës



Formohet Komisioni për organizimin e zgjedhjeve nëpër fshatra

Malishevë, 28 shkurt

Mbledhja e sotme e kuvendit të komunës së Malishevës, ka rezultuar me miratimin e një pjese të rendit të ditës, edhe pse paraprakisht të gjithë deputetët ishin pajtuar me të.

Fillimisht kryesuesi i mbledhjes, z. Ragip Begaj ka hedhur për votim rendin e ditës, i cili kishte parapa, shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, pastaj dy rekomandime nga Komiteti për Politikë e Financa (KPF), atë për formimin e një Komisioni për të mbajtur zgjedhjet nëpër fshatra, si dhe Projekt-Rregullorja Komunale për Ngarkesa Tarifa dhe Gjoba.

Me shumicë votash është vendosur që muaji Maj dhe Qershor, të jenë muajt kur edhe do të mbahen zgjedhjet nëpër fshatra me ç'rast do të zgjidhet kryesia dhe kryesuesit (apo kryetarët) e fshatrave, ndërkohë që Komisioni do të jetë në përbërje prej shtatë anëtarëve, kryesisht anëtarë të kuvendit.

Ndërsa Projekt Rregullorja Komunale për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoba, edhe pse e diskutuar dhe për të cilën dha sqarime dhe shpjegime drejtori i Drejtorisë së Financave, z. Vesel Krasniqi, nuk ka kaluar në mbledhjen e sotme, për shkak të numrit të pakët të deputetëve në seancë, ngase paraprakisht mbledhjen e kishin lëshuar deputetët nga radhët e LDK-së, AAK-së dhe LDD-së.

Përgatitur nga Zyra për Informim Publik- Malishevë